

# Udhëzues për... të kërkuar të parët e tu

Njerëzve u pëlqen të dëgjojnë për të parët e tyre. Kjo gjë na çon në një udhëtim drejt vendeve dhe jetëve të së shkuarës. Është mbresëlënëse të zbulosh çfarë kemi trashëguar – qoftë një trashëgimi e çmuar e familjes apo diçka tjetër nga familja.

## FILLO KËRKIMET

Vendi më i mirë për të filluar kërkimin je ti vetë! Shkruaj në letër gjithçka që di për veten dhe për familjen, duke shënuar:

- Emrat e plotë
- Datat e lindjeve, martesave dhe vdekjeve
- Vendet ku kanë jetuar.

Pyeti edhe të afërmit për këtë informacion, dhe shih se sa larg në të kaluarën shkojnë kujtimet e tyre. Por, kini kujdes që të veproni me takt. Ajo që për ty është pjesë tërheqëse e historisë, mund të jetë një kujtim i dhimbshëm për ta.

## GJETJA E TË DHËNAVE

Kur flet me pjesëtarët e familjes, pyeti nëse mund t'u hedhësh një sy dokumenteve të tyre zyrtare – të cilat shpesh gjenden të ngjeshura në kuti, valixhe e sirtarë! Me vlerë janë sidomos:

- Certifikatat e lindjes, martesore, të vdekjeve
- Testamentet
- Regjistrat e punës
- Pagesa e pensioneve
- Dëftesat e shkollave dhe kurseve profesionale
- Letrat e shërbimit ushtarak.

Kontrollo edhe objektet e trashëguara, siç janë biblat, sepse shpesh njerëzit shpesh i vizatojnë pemët gjenealogjike në kapakët e brendshëm.

Albumet janë një burim tjetër i mirë informacioni. Nëse mundeni, shkruani me laps emrat në pjesën e pasme të fotografive. Nëse mund t'i marrësh hua fotot, mund t'i skanosh në kompjuter ose thuaji dikujt të t'i skanojë. Fotot vërtet mund ta sjellin në jetë pemën gjenealogjike të familjes tënde.

## VIZATO PEMËN GJENEALOGJIKE TË FAMILJES TËNDE

I armatosur me këtë informacion, tani mund të fillosh vizatimin e pemës gjenealogjike të familjes tënde. Merr një fletë të bardhë:

- Shkruaj emrin dhe datëlindjen tënde në gjysmën e poshtme të saj.
- Sipër teje shkruaj emrat e nënës dhe babait, dhe mbi ta emrat e prindërve të tyre, e kështu me radhë.
- Shkruaj edhe datat e lindjes dhe vdekjes së personave, nëse i di.

## NDIHMA

Për të mbushur boshllëqet në kërkimin tënd, mund të kesh nevojë të kërkosh përtej familjes. Ka shumë burime informacioni dhe njerëz që do të ndihmojnë të gjesh këtë informacion.

## BIBLIOTEKA LOKALE

Një thesari për këdo në kërkim të historisë së familjes apo historisë lokale. Pyet punonjësën e bibliotekës të të tregojë si përdoren katalogët. Ata mund të të thonë gjëra të dobishme mbi shoqëritë lokale dhe organizata të tjera.

Qendrat UK Online, disa prej të cilave gjenden nëpër biblioteka, mund të të ndihmojnë në kërkimet e tua duke përdorur faqe të ndryshme interneti.

Telefono falas në numrin 0800 77 1234 për të gjetur qendrën më të afërt.

## LIBRA DHE REVISTA

Këtu po paraqesim një listë bazë. Është mirë që të kontrolloni nëse biblioteka i ka këto, ose nëse mund t'i porosisni?

*Writing up Your Family History: A do-it-yourself guide* nga John Titford

*Track Down Your Ancestors: How to Research Your Family History Using Archives & The Internet* nga Estelle Catlett

*Who Do You Think You Are?*, nga seria e BBC-së ku personazhe të njohur gjurmojnë degët e familjeve të tyre.

*Ancestors Magazine*, nga The National Archives, është mbushur me lajme dhe burime në internet, artikuj dhe këshilla nga ekspertët për të gjurmuar të parët e tu.

## FAQE PËR HISTORITË E FAMILJEVE

Në internet mund të gjesësh shumë nga informacionet që ke nevojë. Një pjesë e informacionit është falas, një pjesë me pagesë.

[www.bbc.co.uk/history/familyhistory](http://www.bbc.co.uk/history/familyhistory) (falas). Faqja e BBC-së është vend i përkryer për të filluar kërkimet e historisë së familjes. Mund të abonohesh falas edhe për një buletin informativ.

[www.ancestry.co.uk](http://www.ancestry.co.uk) (me pagesë).

Faqja më e madhe e arkivave familjare në Mbretërinë e Bashkuar, me arkiva që datojnë deri në vitet 1300. E disponueshme falas në bibliotekat lokale.

[www.genesreunited.co.uk](http://www.genesreunited.co.uk) (pjesërisht falas). Shumë informacione dhe burime të dobishme.

[www.genuki.org.uk](http://www.genuki.org.uk) (falas). Një depo e madhe me këshilla dhe informacione.

## FAQE PËR HISTORINË KULTURORE

[www.besthistorysites.net](http://www.besthistorysites.net)

[www.movinghere.org.uk](http://www.movinghere.org.uk)

## ORGANIZATA TË DOBISHME

*The National Archives* – arkiva qeveritare e Mbretërisë së Bashkuar, që përmban mbi 1,000 vjet histori.

Kew, Richmond, Surrey TW9 4DU.

Tel: 020 8876 3444

[www.nationalarchives.gov.uk](http://www.nationalarchives.gov.uk)

*Society of Genealogists* – biblioteka kombëtare dhe qendra arsimore për historinë e familjeve.

14 Charterhouse Buildings, Goswell Road, London EC1M 7BA.

Tel: 020 7251 8799

[www.sog.org.uk](http://www.sog.org.uk)

*People's Network* – jep akses në internet për një varg shërbimesh publike, duke përfshirë edhe kërkimet për persona.

[www.peoplesnetwork.gov.uk](http://www.peoplesnetwork.gov.uk)



# Bookbite

